



Ndikimi i bashkëmoshatarëve në arritjet shkollore në adoleshencë

Dr. Irma LEKA

Universiteti i Tiranës, Fakulteti Shkencave Sociale Tiranë, Albania
E-mail: lekairma@gmail.com

Abstrakt

Qëllimi kryesor i këtij kërkimi është vlerësimi i marrëdhënies ndërmjet nivelit të përfshirjes së adoleshentëve në shoqërinë reale dhe efekteve që kjo shoqëri shkakton në performancën akademike. Për shkak të pasojave që shoqëria me bashkëmoshatarët sjell në disinteresimin për mësim të adoleshentët, është e nevojshme që të bëhet studimi dhe analiza e tij. Përcaktimi i marrëdhënieve midis nxënësve, shoqërisë dhe shkollës është një çështje themelore në të cilën ndërthuren koncepte kryesore të pedagogjisë dhe psikologjisë. Edukimi është mënyra më e mirë për të mbajtur gjallë brezat në jetë dhe shoqërizimi real ka një ndikim të dukshëm në motivimin në mësim, ndikon drejtpërdrejt në përvetësimin e dijeve të tyre. Në këtë mënyrë, ky studim synon të identifikojë dhe analizojë nivelin e përfshirjes së adoleshentëve me shoqërinë reale dhe ndikimin që kanë ajo në interesin për të mësuar, duke dhënë një tablo të sfidave dhe rreziqeve që vijnë nga këto shoqëri.

Studimi përfshiu një kampion prej 378 subjektësh nga njëzet shkolla 9 -vjeçare publike në qytetin e Tiranës, i cili u përzgjedh me anë të Simple Random Sampling Technique. Për realizimin e këtij studimi u përdor një pyetësor sasior. Studimi vërtetoi se nxënësit që kanë një ndikim të lartë nga bashkëmoshatarët, kanë arritje të ulëta akademike, duke shënuar kështu një rënie në performancën e tyre. Në analizën e regresionit, ka rezultuar gjithashtu se ndikimi i bashkëmoshatarëve në performancën akademike, shpjegon deri në 72% ndryshimin e mesatares akademike.

Në fund, mund të pohohet se gjetjet e këtij studimi tregojnë se rezultatet akademike janë të varura nga ndikimi i bashkëmoshatarëve. Gjetjet zbulojnë, se afërsisht gjysma e adoleshentëve me mesatare të ulët janë të ndikuar nga bashkëmoshatarët. Ky studim mund të ndihmojnë strukturat e Institucioneve të Arsimit të Parauniversitar për të përshtatur teknika dhe metoda efikase në funksion të rritjes së performancës akademike të nxënësve nëpër shkolla.

Fjalë kyçe: bashkëmoshatarë, disinteresim, adoleshent, performancë akademike

Hyrja

Rëndësia e këtij studimi qëndron në aftësinë për të adresuar problemet që lidhen me ndikimin e shoqërisë reale në performancën akademike. Shoqëria reale padyshim po ndikon në performancën akademike të adoleshentëve jo vetëm në kohën e përkushtuar ndaj saj, por edhe në informacionin që ajo transmeton. Për fat të keq, të gjitha këto që po ndodhin në epokën e vrullshme të cilën jemi duke e jetuar, nuk mund të aktualizohen pa një pikë referimi të arritjeve akademike drejt zhvillimit njerëzor dhe shoqëror. Në fjalorin e përgjithshëm online, bashkëmoshatarët janë përcaktuar si "përfshirja në të njëjtin grup shoqëror bazuar sidomos te mosha, klasa, apo statusi"¹. Studimet kanë mbështetur idenë se miqësia me bashkëmoshatarët bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në fillim të adoleshencës dhe ndoshta tejkalon edhe rolin që luajnë prindërit në jetën e tyre.² Ndryshimi i parë gjatë kalimit në adoleshencë është te ndërveprimet e adoleshentëve me bashkëmoshatarët e tyre pasi ato përfshijnë një sasi me të madhe kohës së shpenzuar se sa në periudhën e fëmijërisë, aq sa në një javë normale ata kalojnë dyfishin e kohës me bashkëmoshatarët e tyre (rreth 29%) krahasuar me kohën që rrinë me prindërit (rreth 15%)³. Ndryshime të tjera po sipas këtij autori, qëndrojnë në faktin se grupi funksionon më autonom në këtë periudhë dhe kontrolli i të rriturve mbi adoleshentët bëhet më i pakët, si dhe përfshirja në seksin e kundërt.

Një shoqëri e dyanshme mbahet ndërmjet dy individëve, ku humbja e njërit pjesëtar rezulton në humbjen e shoqërisë, gjë e cila ndryshon nga formimi i shoqërisë në grup te adoleshentët. Grupi është një bashkësi individësh të cilët ndikojnë reciprokisht te njëri-tjetri⁴.

¹ Merriam Webster.com, 2011

² Brown, B. B. (2004). Adolescents' relationships with peers. In R. Lerner & L. Steinberg (Eds.), Handbook of adolescent psychology (2nd ed., pp.363-394). Hoboken, NJ: Wiley.

³ Brown, B. B. (1990). Peer groups and peer cultures. In S. S. Feldman and G. R. Elliott (Eds.), *At the threshold: The developing adolescent* (pp 171-196). Cambridge, MA: Harvard University Press

⁴ Rubin, K.H., Bukowski, W., & Parker, J.G. (1998). Peer interactions relationships, and groups. In W. Damon & N. Eisenberg (Eds.), *Handbook of child psychology: Vol. 4. Social,*



Në adoleshencën e hershme, duhet patur parasysh se është shumë e rëndësishme që marrëdhënia e adoleshentit me shoqërinë të jetë e qëndrueshme, pasi vetë fakti që adoleshentët në moshën 12 vjec kalojnë nga Cikli i Ulët në Ciklin e Lartë në shkollë dhe ndryshimi nga një mësues në shumë mësues i bën ata që të jenë të paqëndrueshëm. Të kuptuarit e qëndrueshmërisë në marrëdhëniet shoqërore, jep mundësinë e pasjes së informacionit për mënyrën se si shoqëria ndikon në performancën shkollore. Tipologjia e grupeve të bashkëmohatarëve mund të përkufizohet në dy akse të ndryshme⁵; grupet e bashkëmohatarëve që mund të gjenden ose në shkollë ose jashtë shkollës dhe këto grupe mund të jenë ose formale ose informale.

Grupet formale të bashkëmohatarëve janë ato që janë organizuar nga shkolla apo nga të rriturit, ndërsa grupet joformale të bashkëmohatarëve janë ato që janë krijuar dhe mirëmbahet nga vetë fëmijët. Në klasë, aktivitetet përfshirëse janë ato në të cilat shumica e mësimit dhe e pjesëmarrjes ndodh brenda klasës. Jashtë klasës programet mund të kenë një komponent instruktiv, por ato kërkojnë angazhim shtesë të nxënësve. Si me çdo tipologji, ajo që kërkohet është një tip ideal dhe tipologjia nuk kërkon nga nxënësit që të bëjnë pjesë vetëm në një kategori. Nxënësit duhet të pretendojnë anëtarësimin në një shumëllojshmëri të rrjeteve të ndryshme sociale.

Bashkëmohatarët dhe performanca akademike

Ndërveprimet shoqërore në adoleshencë janë normale dhe pjesë thelbësore të procesit të të mësuarit që ndikojnë jetën e zakonit gjatë të mësuarit të nxënësve. Sidomos gjatë adoleshencës, bashkëmohatarët janë një burim i ndikimit në të gjithë botën, qoftë në zonat rurale apo urbane. Një ndikim i tillë mund të ndihmojë ose të pengojë arritjet akademike nxënësve në varësi të vlerave që ka grupi si dhe efektivitetit të mekanizmit për kontrollin shoqëror që ushtrohet nga grupi mbi anëtarët e saj⁶; është e nevojshme që të vendosen qëndrime nga prindërit apo mësuesit kundrejt influencës së grupit e cila ndikon në performancën akademike të nxënësve. Kjo është për shkak se krijimi i qëndrimeve të tilla mund të ndihmojnë në gjetjen e mënyrave më të mira për rritjen e të nxënësve.

Në një studim të bërë nga Wentzel dhe Caldwell për të parë lidhjen midis shoqërisë dhe performancës akademike me 404 adoleshentë rezultoi se ka një lidhje sinjifikante midis të dyjave⁷. Efektet në marrëdhëniet shoqërore janë reciproke. Ky studim mbështet faktin që marrëdhëniet midis adoleshentëve dhe bashkëmohatarëve gjatë viteve të shkollës janë potencialisht të rëndësishme për të kuptuar nivelin e tyre në arritjet shkollore.

emotional, and personality development (5th ed., pp. 619-700). New York: Wiley.)

⁵ *The Impact of Peers on College Preparation: A Review of the Literature ...* Center for Higher Education Policy Analysis (CHEPA) <http://www.uscrossier.org/>.

⁶ Cobb, J. Nancy, (2007). *Adolescence: Continuity, Change and Diversity* (6th Ed) New York: McGraw-Hill

⁷ Zitzmann, N. A. 2005. "Peer Relations And Academic Achievement In Early Elementary School". Louisiana State University. Vol. 51 hal. 345.

Bashkëmohatarët mund të jenë një faktor i rëndësishëm që ndikojnë zakonet e studimit, synimet e punës dhe qëllimet në jetë⁸. Bashkëmohatarët kanë ndikime të rëndësishme në rezultatet e nxënësve, gjithmonë në varësi të influencës që ka grupi mbi ata.

Të mësuarit dhe angazhimi

Siç dihet procesi i të mësuarit ka në qëndër të vëmëndjës motivimin i cili përbën thelbin e mësimdhënies ndër vite. Të mësuarit është një proces i komplikuar dhe dinamik, dhe të mësuarit në kuptimin e vërtetë kompletohet me anë të motivimit. Duke qënë se dëshira për të mësuar është elementi bazik i performancës akademike, shpeshherë ndodh që nxënësit ta humbasin interesin ndaj mësimit për arsye të ndryshme. Për dekada me radhë, kalimi nga njëri cikël në tjetrin në shkollë, është shoqëruar me probleme në arritjet arsimore, në motivimin akademik dhe në sjelljen e përshtatjen sociale⁹. Të mësuarit e nxënësve mund të përkufizohet si nivel i pjesëmarrjes dhe interesit të brendshëm që një nxënës tregon në shkollë¹⁰. Të mësuarit në detyrat e shtëpisë përfshijnë sjellje si këmbëngulja, përpjekja apo vëmendja dhe qëndrimet që përfshijnë motivimin, vlerat pozitive të mësuarit, entuziazmin, interesin, krenarinë në sukses. Kështu që nxënësit angazhohen në aktivitete, brenda dhe jashtë klasës, që çojnë në suksesin apo të mësuarit. Po sipas këtyre autorëve, ata gjithashtu shfaqin kuriozitet, dëshirë për të ditur më shumë dhe përgjigje pozitive emocionale të mësuarit në shkollë. Dhe në këtë moment ndodh që rolet sociale dhe dinamika e zhvillimit të adoleshencës të paraqesin barrkada në arritjet akademike, apo shqetësime në aktivitete të tjera të cilat zënë vëmendjen dhe energjinë e nxënësve. Çështjet ndërpersonale me bashkëmohatarët zakonisht marrin rëndësi të shtuar, duke ndërhyrë kështu në punën akademike¹¹. Për të adresuar vështirësitë që lidhen me të mësuarit, ndryshimin e lëndëve mësimore, me kalimin nga njëri cikël në tjetrin, një shumëllojshmëri ndryshimesh organizative kanë qënë të propozuara. Ndryshime të veçanta që mund të rrisin efektivitetin në performancën akademike përfshijnë, ruajtjen e madhësive të po të njëjtave klasave në të cilat grupet e nxënësve kanë qënë së bashku për shumicën e viteve në Ciklin e Ulët, duke shmangur kështu përdorimin e grupeve të aftësisë¹².

⁸ Allen, Tammy, D, Stach, E. McMamus, and Royce, E. A. Russell (1999). "Newcomer Newcomer Socialization and Stress: Formal Peer Relationships as a Source of Support. *Journal of Vocational Behavior* 54, 453-470 (1999)

⁹ Anderman, E. M. and Mueller, C.E. 2010 Middle school transitions and adolescent development. In J. L. Meece & J. S. Eccles (Eds.), *Handbook of research on schools, schooling, and human development* (pp.198 – 215) .

¹⁰ Newmann, Fred M., Gary Wehlage, and Susie D. Lamborn. 1992. "The Significance and Sources of Student Engagement." Pages 11-39 in Fred M. Newmann (ed.), *Student Engagement and Achievement in American Secondary Schools*. New York: Teachers College Press.

¹¹ Po aty

¹² Eccles, J. S. 1999. *The development of children ages 6 to*



Angazhimi dhe motivimi janë elemente kritike në suksesin dhe të mësuarit e nxënësve. Studiuesit mendojnë se nxënësit që janë më të angazhuar, mësojnë më shumë dhe marrin pjesë më shumë në aktivitete se nxënësit të cilët nuk janë të angazhuar. Shumë studime i kanë identifikuar nivelet e larta të angazhimit të nxënësve, si përcaktuese të rëndësishme të rezultateve në testet e standardizuara, të mësuarit në klasë dhe notave që marrin¹³.

Metodologjia e studimit


Qëllimi i studimit ishte evidentimi i ndikimit që ka shoqëria reale në disinteresimin për mësim në adoleshencë. Hipoteza e këtij studimi ishte: Ekziston një lidhje e rëndësishme statistikisht midis ndikimit të bashkëmoshatarëve dhe ecurisë akademike të nxënësve. Mbledhja e informacionit, duke u bazuar në hipotezën e studimit, u krye në bazë të një pyetësori për adoleshentët. Pyetësori për nxënësit analizon nivelin e përfshirjes së adoleshentëve me shoqërinë reale dhe efektet që ka ajo në performancën akademike. Pyetësori përmban pyetje të cilat synojnë të masin pëlqyeshmërinë e nxënësve kundrejt shkollës dhe ndikimin që kanë ata nga shoqëria si në rezultatet në mësim ashtu edhe në lënien e orëve mësimore. Më pas nga këto të dhëna janë nxjerrë të dhënat për problemet që dalin në fushën akademike. Për të vlerësuar pëlqyeshmërinë ndaj shkollës janë përdorur shkallë specifike ku secila prej tyre paraqet nënshkallët e veta dhe për matjen e loqërizimit real apo virtual është aplikuar shkalla e Likert-it: (a) *kurrë*; (b) *rrallë*; (c) *ndonjëherë*; (d) *shpesh*; dhe (e) *gjithmonë*. Pyetësori i ka dhënë një rëndësi të vecantë këndvështrimit të nxënësve mbi rëndësinë që ata i japin shoqërisë reale, kohës që ata i përkushtohen këtyre shoqërive dhe bashkëpunimit të tyre me shoqërinë përse i përket procesit mësimor. Në këtë studim janë përfshirë 64 shkolla 9 - vjeçare të qytetit të Tiranës të cilat në total kanë një numër prej 22787 nxënësish. Në këtë popullatë nuk përfshihen nxënësit e shkollave jo-publike dhe instituti i atyre që nuk shikojnë dhe dëgjojnë. Popullata target e këtij studimi u realizua në bazë të të dhënave të Drejtorisë Arsimore Rajonale të Tiranës. Grupmosha e perzgjedhur ishte nga 12 – 15 vjeç, ose e përcaktuar në klasa nga kl. VI – IX, pasi kjo grupmoshë ishte targeti studimi. Duke qënë se studimi ishte sasior, për kryerjen e analizave të të dhënave janë përdorur metodat statistikore. Në mbarimin e mbledhjes së të dhënave, është bërë kodimi i tyre dhe më pas nëpërmjet paketës statistikore IBM SPSS version 19, u ndërtua baza e tyre, ku u përfshinë analiza deskriptive dhe ajo statistikore.

14. *The Future of Children*, 9: 30–44.

¹³ National Research Council. 2000. *How People Learn: Brain, Mind, Experience, and School, Expanded Edition*. John Bransford, Ann L. Brown, and Rodney R. Cocking (eds.), Committee on Developments in the Science of Learning, Committee on Learning Research and Educational Practice, Commission on Behavioral and Social Sciences and Education. Washington, DC: National Academy Press.

Analiza e të dhënave

Një pjesë e rëndësishme e këtij studimi ishte të shikohej impakti që kanë bashkëmoshatarët dhe influencimi që ata mund t'i bëjnë ecurisë akademike të nxënësve. Analizat deskriptive treguan se mesatarja e ndikimit të grupit të bashkëmoshatarëve në disinteresimin për aktivitetet akademike ishte 28.1. Bazuar në vlerat minimale dhe maksimale u rikategorizua kjo ndryshore në 3 kategori për të parë frekuencën e shpërndarjes së saj në kampion. Të dhënat tregojnë se afërsisht 42% e kampionit shfaqin një ndikim të ulët nga bashkëmoshatarët përse i përket disinteresimit për mësim, ndërkohë që 36% shfaqin një ndikim të moderuar dhe 22% një ndikim të madh nga bashkëmoshatarët.



Analiza e frekuencës për varësinë nga bashkëmoshatarët

Për të parë në mënyrë akoma më të detajuar lidhjen midis variablave të *mesatares akademike dhe ndikimit të shoqërisë* u vendosën të bëhen analiza kros-tabuluese midis këtyre variablave. Fillimisht, këto variabla u kthyen nga variabla të vazhdueshme në variabla kategorike duke përdorur llogaritjen e kufirit minimal dhe kufirit maksimal. Më pas u panë lidhjet krostabulative midis mesatares akademike dhe ndikimit të shoqërisë dhe u vu re se pjesa dërrmuese e individëve të cilët kanë mesatare të lartë akademike kanë një ndikim të ulët nga bashkëmoshatarët përse i përket disinteresimit për mësimin (përkatesisht 98.9 e individëve të cilët janë kategorizuar me mesatare të lartë akademike). Ndërkohë që individët të cilët kanë mesatare të ulët akademike kanë në shumicë ndikim të moderuar nga bashkëmoshatarët (49.7%) dhe ndikim të lartë nga bashkëmoshatarët (44.6%). Vetëm 5.6% e atyre që kanë mesatare të ulët akademike kanë edhe ndikim të ulët nga bashkëmoshatarët.

Ky studim është studim korrelacional ndërseksional dhe si i tillë nuk ka qëllim që të gjejë një lidhje *shkak-pasojë* midis variablave të marra në studim, çfarë do ishte ideale nga pikëpamja studimore. Megjithatë nëpërmjet analizës regressive u përcaktua sesa njëri variabël mund të parashikohet nga variabli tjetër. Kështu, në rastin tonë variabli i parashikuar është *mesatarja akademike*, ndërsa variabli i paparashikuar ishte *ndikimi i shoqërisë* Për të



parë sesa ndryshon mesatarja akademike duke pasur parasysh variablin tjetër, u përdor metoda e regresionit të thjeshtë linear. Siç tregon tabela e mëposhtme, të dhënat tregojnë që ndryshimi i variablës së mesatares akademike si rrjedhojë e variablit tjetër është domethënës nga ana statistikore. Koeficienti i R-së në katror që tregon se sa ndryshon mesatarja akademike si rrjedhojë e ndryshimit të variablit tjetër është mjaft i rëndësishëm. Në tabelën e mëposhtme janë paraqitur edhe ndryshimet përkatëse të koeficientit të R-së. Kështu afërsisht 72% e ndryshimit të variablit të mesatares mund ti atribuohet ndryshimit të variablës së ndikimit të bashkëmoshatarëve.

Metoda e regresionit të thjeshtë linear

Modeli	B	Gabimi Standart	Beta	F	R2 i ndryshuar	Sigma
Ndikimi i bashkëmoshatarëve	10.207	.106	-.846	1003.536	.716	.000

Interpretimi i gjetjeve

Natyrë e përfshirjes së adoleshentëve me grupet e bashkëmoshatarëve, ndryshon gjatë adoleshencës. Sipas Savin-Williams & Berndt, (1990)¹⁴, adoleshentët zakonisht kanë të paktën një grup kryesor bashkëmoshatarësh, me të cilët ata identifikohen dhe janë të ngjashëm në shumë aspekte. Gjatë kohës së adoleshencës, përfshirja në grup ka tendencë të jetë më intensive dhe shqetësimet në lidhje me pranimin nga grupi janë në kulmin e tyre. Micucci (1998)¹⁵ dhe Santrock (2001)¹⁶ kanë arritur në përfundimin se, dëshira e fortë për të bërë pjesë në një grup të caktuar, mund të ndikojë te adoleshentët për të shkuar së bashku në aktivitete në të cilat në të kundërt nuk do të angazhoheshin. Në këtë periudhë, adoleshentët kanë nevojë për të rriturit të cilët mund t'i ndihmojnë ata të përballojnë presionin e bashkëmoshatarëve dhe të gjejnë alternativa të ndryshme për tu përballur me këtë presion.

Gjatë viteve të formimit të adoleshentëve, bashkëmoshatarët janë ndoshta edhe më të rëndësishëm se sa prindërit, mësuesit apo individë të tjerë dhe vendimet e bashkëmoshatarëve tek ata mund të ketë pasojë afatgjatë¹⁷. Për këtë arsye, duhet patur parasysh që këto vendime të jenë të ekuilibruara, në mënyrë që pasojat të mos jenë negative.

Në studimin tonë, një çështje mjaft e rëndësishme ku u vendos theksi, ishte edhe gjetja e lidhjes midis mesatares së notave dhe influencës negative të bashkëmoshatarëve në procesin e të nxënësve. Të dhënat treguan se lidhja

korrelacionale midis këtyre dy faktorëve ishte e fortë dhe negative ($r = -.846$), që do të thotë me rritjen e influencës negative të shoqërisë ulet mesatarja akademike e nxënësve që marrin pjesë në studim. Fakti që koeficienti korrelacional ka një vlerë aq të lartë, tregon që rritja apo ulja e njërit prej faktorëve, do ndikojë në mënyrë të ndjeshme dhe proporcionalisht rritjen apo uljen e faktorit tjetër. Kjo vjen në pritsmëri me hipotezën e studimit që pohon se ekziston një lidhje e rëndësishme statistikisht midis ndikimit të bashkëmoshatarëve dhe ecurisë akademike të nxënësve.

Gjetje të tilla raportohen nga studimet e Badenes (2000)¹⁸, sipas të cilëve, marrëdhëniet problematike me bashkëmoshatarët vazhdimisht kanë qenë të lidhura me rezultate të dobëta akademike. Bashkëmoshatarët janë ndër forcat shoqërore më me ndikim në sjelljen e adoleshentëve, nga vendimet më të thjeshta e deri te vendimet më të rëndësishme që kanë të bëjnë ecurinë akademike.

Edhe pse shumë studime e vënë fokusin në një pikëpamje negative të ndikimit të bashkëmoshatarëve në performancën akademike, ka disa të tjera që e shohin këtë ndikim pozitivisht. Përveç të qenit mbështetës, argumenti është në përputhje me Cobb (2007)¹⁹ i cili vë në dukje se ndërveprimet mes bashkëmoshatarëve janë normale dhe kjo është një pjesë thelbësore e procesit të të mësuarit e cila influencën të mësuarin për një kohë të gjatë në zakonet e nxënësve. Arsyeja kryesore për një bashkëveprim të mirë midis bashkëmoshatarëve është mundësia që ata i japin njëri tjetrit për ndihmë në detyrat mësimore. Ky argument duket i besueshëm dhe mund të vërtetohet ekzistencën e grupimeve pozitive, duke eliminuar kështu në një masë të gjerë edhe veset antisociale që sjell grupi.

Rezultatet që u nxorën nga pjesa sasiore e studimit, treguan tre kategoritë e vështirësive më të mëdha që nxënësve hasnin:

1. Shoqërizimi me bashkëmoshatarë që kishin arritje të ulëta në shkollë
2. Koha e harxhuar me shoqërinë brënda dhe jashtë klasës.
3. Prishja e orës gjatë procesit mësimor për shkak të zhurmave të nxënësve problematikë

Problemet e ngacmimit nga të tjerët, ndikimin arritjet akademike të fëmijëve dhe nivelin e përshtatshmërisë dhe kënaqësisë me shkollën. Nxënësve që kishin pasur probleme ngacmimi nga të tjerët në shkollë, kishin arritje akademike më të ulëta sesa nxënësve që nuk kishin pasur të tilla probleme. Ky ndikim rezultoi me një madhësi të lartë efekti. Analizat përshkruese vërtetuan se nxënësve që kishin probleme gjatë procesit mësimor (si rrjedhojë e tërheqjes së vëmëndjes nga nxënësve problematikë, zhurmave etj), rezultuan të kishin nivelet më të ulëta në rezultatet shkollë. Sic e shihet edhe në studim, pjesa dërrmuese e individëve të cilët kanë mesatare të lartë akademike kanë një ndikim të ulët nga bashkëmoshatarët

¹⁴ Savin-Williams, R. C., & Berndt, T. J. (1990). Friendship and peer relations. In S. S. Feldman & G. R. Elliot (Eds.), *At the threshold: The developing adolescent*. Cambridge, MA: Harvard University Press

¹⁵ Micucci, J. A. (1998). *The adolescent in family therapy: Breaking the cycle of conflict and control*. New York: Guilford.

¹⁶ Santrock, J. W. (2001). *Adolescence* (8th ed.). New York: McGraw-Hill.

¹⁷ Sewell, William H., and Robert M. Hauser. 'The Wisconsin Longitudinal Studies of Social and Psychological Factors in Aspirations and Achievements.' *Research in Sociology of Education and Socialization* 1 (1980).

¹⁸ Badenes, L.V., Estevan, R.A.C., & Bacete, F.J.G. (2000). Theory of mind and peer rejection at school. *Social Development*, 9, 271–283.

¹⁹ Cobb, J. Nancy, (2007). *Adolescence : Continuity, Change and Diversity*. (6th Ed) New York : McGraw-Hill.



përsa i përket disinteresimit për mësimin (përkatësisht 98.9 e individëve të cilët janë kategorizuar me mesatare të lartë akademike). Ndërkohë që individët të cilët kanë mesatare të ulët akademike kanë në shumicë ndikim të moderuar nga bashkëmoshatarët (49.7%) dhe ndikim të lartë nga bashkëmoshatarët (44.6%). Vetëm 5.6% e atyre që kanë mesatare të ulët akademike kanë edhe ndikim të ulët nga bashkëmoshatarët.

Pra, gjetjet e këtij studimi tregojnë se rezultatet akademike janë të varura nga ndikimi i bashkëmoshatarëve. Gjetjet zbulojnë, se afërsisht gjysma e adoleshentëve me mesatare të ulët janë të ndikuar nga bashkëmoshatarët. Këta adoleshentë mund të gjenerojnë më shumë ide negative nga grupi në të cilin bëjnë pjesë dhe kjo mund të çojë në rënie të rezultateve të tyre. Kjo është në përputhje me studimet e tjera nga Paola & Scoppa (2010)²⁰, studim në të cilin është deklaruar se ndikimi i grupit ka efekt të rëndësishëm në performancën akademike. Adoleshentët që kanë mesatare të ulët, ndikohen nga bashkëmoshatarët, pasi ata mund të fokusohen më tepër në interesa jashtë klase me njëri tjetrin, se në ato çfarë kanë lidhje me performancën akademike. Me fjalë të tjera, adoleshentët për të provuar pavarësinë e tyre, kanë tendencën të përqëndrohen te presioni negativ i bashkëmoshatarëve apo në sjelljet antisociale, sesa në arritjet akademike. Duke i kushtuar vëmëndje këtij presioni të bashkëmoshatarëve, ata e zhvendosin vëmëndjen nga presioni i notës në klasë.

Të marra së bashku, evidencat duket se tregojnë qartas lidhjen e bashkëmoshatarëve me rezultatet akademike, të shpjeguara pjesërisht me modelin e vetë sistemit, por që rrugë alternative duhet të identifikohen për lidhjen midis pranimit të bashkëmoshatarëve dhe rezultateve akademike. Gjithashtu, siç tregohet më lart, ne nuk mund të përjashtojmë mundësinë që lidhja midis marrëdhënieve me bashkëmoshatarët dhe rezultateve akademike, të shkaktohet edhe nga disa karakteristika të tjera të cilat janë të nevojshme të identifikohen. Sidoqoftë, përveç këtyre masave të individualizuara të mjedisit kolegëve, cilësia e përgjithshme e marrëdhënieve midis bashkëmoshatarëve në mjedisin e klasës është e rëndësishme²¹. Është e mundshme që cilësia e përgjithshme e ndërveprimeve të bashkëmoshatarëve brenda klasës të ndikojë në efektin që ata kanë në rezultatet akademike. Kjo ide buron nga modelet e kontekstit social, të cilat njohin normat e grupit në një kontekst shoqëror, në të cilin adoleshenti ndërvepron dhe e modifikon kuptimin e marrëdhënieve me bashkëmoshatarët dhe kështu mund të gjenerojë rezultate të ndryshme. Në mbështetje të studimit tonë, është edhe Johnson (2000)²², i cili në studimin e tij tregoi

një efekt sinjifikativ të qëndrimeve të bashkëmoshatarëve ndaj arritjeve akademike të nxënësve në shkolla publike. Në studim u përdor baza e të dhënave të Vlerësimit Kombëtar e Progresit Arsimor dhe u gjet se ndikimi i bashkëmoshatarëve ishte një nga përcaktuesit më të mëdhenj të arritjeve akademike. Sipas këtij studimi, rëndësia e ndikimit të bashkëmoshatarëve zbehet pas moshës 14 vjeç, rezultat i cili duket në kundërshtim me studime të tjera që sugjerojnë se ky efekt ka kulmin e vet në këtë moshë.

Perfundime

Për objektivin e pestë u vendos theksi te gjetja e lidhjes midis mesatares së notave dhe influencës negative të bashkëmoshatarëve në procesin e të nxënësve. Të dhënat treguan se lidhja korrelacionale midis këtyre dy faktorëve ishte e fortë dhe negative ($r = -.846$), që do të thotë se rritjen e influencës negative të shoqërisë ulet mesatarja akademike e nxënësve që marrin pjesë në studim. Fakti që koeficienti korrelacional ka një vlerë aq të lartë, tregon që rritja apo ulja e njëri prej faktorëve, do ndikojë në mënyrë të ndjeshme dhe proporcionalisht rritjen apo uljen e faktorit tjetër. Kjo vjen në pritshmëri me hipotezën e studimit që pohon se ekziston një lidhje e rëndësishme statistikisht midis ndikimit të bashkëmoshatarëve dhe ecurisë akademike të nxënësve. Pra, gjetjet e këtij studimi tregojnë se rezultatet akademike janë të varura nga ndikimi i bashkëmoshatarëve. Gjetjet zbulojnë, se afërsisht gjysma e adoleshentëve me mesatare të ulët janë të ndikuar nga bashkëmoshatarët. Këta adoleshentë mund të gjenerojnë më shumë ide negative nga grupi në të cilin bëjnë pjesë dhe kjo mund të çojë në rënie të rezultateve të tyre

Rekomandime

1. Nxënësit duhet të krijojnë një ekuilibër mes aktiviteteve akademike dhe pengesave që vijnë nga shoqëria reale.
2. Duhet të ketë një rënie të numrit të kohës së shpenzuar nga adoleshentët me shoqërinë reale.
3. Administratorët e shkollave duhet të kenë në departamentet e tyre, udhëzime të cilat kanë si qëllim këshillimin e grupeve të bashkëmoshatarëve mbi vlerat që duhet të kenë këto grupe.
4. Shkollat duhet të brendësojnë në mënyrë organike instrumentet e rinj të komunikimit që shoqëria i përdor në mënyrë të përditshme.

²⁰ Paola M and Scoppa V, (2010): "Peer group effects on the academic performance of Italian students," Applied Economics, Taylor & Francis Journals, vol. 42(17), pages 2203-2215.

²¹ Kindermann, T. A. (1993). Natural peer groups as contexts for individual development: The case of children's motivation in school. *Developmental Psychology*, 29, 970–977.

²² Kirk A. Johnson, "The Peer Effect on Academic Achievement Among Public Elementary Students," CDA Report No. 00-06, May 26, 2000, Heritage Center for Data Analysis, Heritage Foundation, 214 Massachusetts Avenue N.E., Washington D.C., 20002, (202) 546-4400. - See more at: <http://www.npc.org/sub/>



Referencat

1. Allen, Tammy, D, Stach, E. McMamus, and Royce, E. A. Russell (1999). "Newcomer Newcomer Socialization and Stress: Formal Peer Relationships as a Source of Support. *Journal of Vocational Behavior* 54, 453–470 (1999)
 2. Anderman, E. M. and Mueller, C.E. 2010 Middle school transitions and adolescent development. In J. L. Meece & J. S. Eccles (Eds.), *Handbook of research on schools, schooling, and human development* (pp.198 – 215).
 3. Badenes, L.V., Estevan, R.A.C., & Bacete, F.J.G. (2000). Theory of mind and peer rejection at school. *Social Development*, 9, 271–283.
 4. Brown, B. B. (1990). Peer groups and peer cultures. In S. S. Feldman and G. R. Elliott (Eds.), *At the threshold: The developing adolescent* (pp 171-196). Cambridge, MA: Harvard University Press)
 5. Brown, B. B. (2004). Adolescents' relationships with peers. In R. Lerner & L. Steinberg (Eds.), *Handbook of adolescent psychology* (2nd ed., pp.363-394). Hoboken, NJ: Wiley.
 6. Cobb, J. Nancy, (2007). *Adolescence: Continuity, Change and Diversity (6th Ed)* New York: McGraw-Hill
 7. Eccles, J. S. 1999. The development of children ages 6 to 14. *The Future of Children*, 9: 30–44.
 8. Kindermann, T. A. (1993). Natural peer groups as contexts for individual development: The case of children's motivation in school. *Developmental Psychology*, 29, 970–977.
 9. Kirk A. Johnson, "The Peer Effect on Academic Achievement Among Public Elementary Students," CDA Report No. 00-06, May 26, 2000, Heritage Center for Data Analysis, Heritage Foundation, 214 Massachusetts Avenue N.E., Washington D.C., 20002, (202) 546-4400. - See more at: http://www.ncpa.org/sub/dpd/index.php?Article_ID=9745#sthash.tjqCKcz3.dpuf.
 10. Merriam Webster.com, 2011
 11. Micucci, J. A. (1998). *The adolescent in family therapy: Breaking the cycle of conflict and control*. New York: Guilford.
 12. National Research Council. 2000. *How People Learn: Brain, Mind, Experience, and School, Expanded Edition*. John Bransford, Ann L. Brown, and Rodney R. Cocking (eds.), Committee on Developments in the Science of Learning, Committee on Learning Research and Educational Practice, Commission on Behavioral and Social Sciences and Education. Washington, DC: National Academy Press.
 13. Newmann, Fred M., Gary Wehlage, and Susie D. Lamborn. 1992. "The Significance and Sources of Student Engagement." Pages 11-39 in Fred M. Newmann (ed.), *Student Engagement and Achievement in American Secondary Schools*. New York: Teachers College Press.
 14. Paola M and Scoppa V, (2010): "Peer group effects on the academic performance of Italian students," *Applied Economics*, Taylor & Francis Journals, vol. 42(17), pages 2203-2215.
 15. Rubin, K.H., Bukowski, W., & Parker, J.G. (1998). Peer interactions *relationships*, and groups. In W. Damon & N. Eisenberg (Eds.), *Handbook of child psychology: Vol. 4. Social, emotionall, and personality development* (5th ed., pp. 619-700). New York: Wiley.)
 16. Santrock, J. W. (2001). *Adolescence* (8th ed.). New York: McGraw-Hill.
 17. Savin-Williams, R. C., & Berndt, T. J. (1990). Friendship and peer relations. In S. S. Feldman & G. R. Elliot (Eds.), *At the threshold: The developing adolescent*. Cambridge, MA: Harvard University Press
 18. Sewell, William H., and Robert M. Hauser. 'The Wisconsin Longitudinal Studies of Social and Psychological Factors in Aspirations and Achievements.' *Research in Sociology of Education and Socialization* 1 (1980).
- The Impact of Peers on College Preparation: A Review of the Literature ...* Center for Higher Education Policy Analysis (CHEPA) <http://www.uscrossier.org/>.
- Zitzmann, N. A. 2005. "Peer Relations And Academic Achievement In Early Elementary School". *Louisiana State University*. Vol. 51 hal. 345.